Shpresa Breçani
Auditúese Ligjore
Licence nr. 143

# RAPORTI I AUDITUESES LIGJORE

*Per verifikimin e procedurave te zmadhimit te kapitalit te shoqërisë*

**"SHPRESA-AL" shpk**

NIPT K31321021N

Adresa: Rr Panorama, Pall. Sara-El, prane Hipotekes, TIRANE, Kati I, Ap I.
Tel / fax: 04 - 2223331, Mob +355 68 20 94103 Email: sh.brecani@yahoo.com, www.shbcg.com

**Drejtuar: Ortakut te vetem te Shoqerise "SHPRESA-AL" shpk**

**Z. Lush Osmani**

Unë, Shpresa Brecani, me profesion Audituese Ligjore me license profesionale Nr.143, date 29.06.2005 lëshuar nga IEKA, jam caktuar eksperte në misionin për verifikimin e procedurave te zmadhimit te kapitalit të shoqërisë **"SHPRESA-AL" shpk**, sipas Vendimin **Nr.48, datë 29.06.2023** i Ortakut të vetëm të Shoqërisë "SHPRESA-AL" shpk dhe ne zbatim te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare".

Pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe financiar të shoqërisë **"SHPRESA-AL" shpk**, jap perfundimet e mia ne raportin qe vijon:

**Qellimi i Anagazhimit**

Ne baze te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare", te Vendimit te Ortakut te vetem te "SHPRESA-AL" shpk, Nr. 48, date 29.06.2023, si dhe te pasqyrave financiare te vitit ushtrimore 2022, une, Shpresa Breçani me profesion Audituese Ligjore kam realizuar angazhimin tim per verifikimin e procedurave te kryerjes se zmadhimit te kapitalit te shoqerise ne para, nepermjet kapitalizimit te fitimet te vitit ushtrimor, ne perputhje me Standardin Nderkombetar te Dhenise se Sigurise.
Ky Standad kerkon qe une te planifikoj dhe te kryej procedurat ne menyre qe te arrij nje nivel te arsyeshme sigurie.

**Pergjegjesia e Drejtimi**

Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen ne perputhje me kerkesat ligjore per përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë te deklarimeve financiare, juridike dhe e informacioneve të tjera të domosdoshme për dhënien e sigurisë së procesit të hartimit te pasqyrave financiare dhe te ndryshimit te kapitalit.

Drejtimi eshte gjithashtu pergjegjes te ndermarre ne kohe te gjitha veprimet e nevojshme per realizimin e procesit te zmadhimit te kapitalit, te dorezimit te dokumentacionit prane QKR-se dhe te njoftoje palet e interesuara per procesin e zmadhimit te kapitalit me terheqjen e fitimeve te kapitalizuara.
Drejtimi ka pergjegjesine te garantoje se nuk eshte i perfshire ne ndonje proces falimentimi apo likujdimi.

**Pergjegjesia e Auditueses Ligjore**

Pergjegjesia ime eshte te jap nje opinion mbi sigurine e procesit bazuar në verifikimin e procedurave, te metodave te perdoruara per te arritur zmadhimit e kapitalit, si dhe pershtatshmerine e perdorimit te ketyre metodave.

**OPINION**

Sipas Opinionit tim, pasi verifikova procedurat për zmadhimin e Kapitalit të shoqerise **"SHPRESA-AL"** shpk, opinioni im per Vendimin e Ortakut te vetem eshte i drejte dhe sipas Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe Ligjit Nr.7923 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Audituese Ligjore
Shpresa BREÇANI
Nr.Lic.143.

Tirane, me 18.12.2023

## I. BAZA LIGJORE PER KRYERJEN E KETIJ MISIONI ESHTE:

1. Ligji Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregetare".
2. Ligji Nr.9723 date 03.05.2007 "Per QKR-ne".
3. Vendimi i Ortakut te vetem te Shoqerise "SHPRESA-AL" shpk per zmadhimin e kapitailit dhe rezerves ligjore Nr.48 date 29.06.2023.
4. Bilanci i vitit ushtrimor 2022 te shoqërisë "SHPRESA-AL" shpk.
5. Statuti dhe Akti i themelimit te shoqerise "SHPRESA-AL" shpk.

## II. PROCEDURAT E ANGAZHIMIT PERFSHIJNE:

- Verifikimi i llogarive analitike si dhe kontrolli i llogarive specifike parashikuar nga Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"; Ligji Nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar"; Ligji Nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";.
- Verifikimi i vlerës dhe i dokumentacionit përkatës lidhur me proceduren e zmadhimit te kapitalit, bazuar ne Pasqyrat Financiare;
- Në verifikimin e dokumentacionit;
-Verifikimit të dokumentave juridikë;
-Ne evidenca të tjera të domosdoshme;
-Ne regjistrimet perfundimtare te ndryshimit te kapitalit;
-Verifikimi i Situates ekonomiko- financiare e shoqerise para momentit te zmadhimit te kapitalit.

## III. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SHOQËRINË.

Shoqeria "SHPRESA-AL" shpk Tirane, eshte krijuar si person juridik me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane me Nr.27248 date 21.02.2002 me kapital fillestar te nënshkruar ne vlerën 100.000 leke, me vlere nominale te kuotave 1.000 leke secila dhe me pjesëmarrje aktuale 100% ne kapital te shoqërisë të Ortakut te vetëm Z. LUSH OSMANI.

Kapitali aktual i shoqerise eshte 134.530.343 lekë, i cili perbehet nga kapital ne para, 107.050.000 leke, i ndare ne 107.050 kuota me vlere nominale 1.000 leke, dhe kapital ne natyre ne vlere 27.480.343 leke, zotëruar 100% nga ortaku i vetem z. Lush Osmanaj.

**Selia e shoqerise eshte ne adresen**: Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga "Urani Pano", mbrapa "Veve Center", Pallati Nr.11, Kati 2, Tirane.
Shoqeria eshte regjistruar prane organeve tatimore Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve te Medhenje dhe pajisur me NIPT K31321021N.

**Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte**:
Transport mallrash dhe pasagjeresh brenda dhe jashte vendit. Tregtim me shumice dhe pakice artikuj te ndryshem, industriale, ushqimore, pajisje elektroshtepiake dhe elektronike, konfeksione, kinkalerie, materiale ndertimi, vegla pune, fruta - perime, produkte ushqimore, blegtorale, makineri, vegla bujqesore, vajra lubrifikante ne menyre stacionare, distributor dhe ambulant. Tregtim te karburanteve dhe nenprodukteve te tij (nafte, benzine, solar, bitum), inerte te llojeve te ndryshme etj.Aktivitet ndertimi, transporti, mallrash e udhetaresh,sherbime pub,grumbullime, perpunime bime mjeksore,shfrytezim minerale, tregti e lendeve plasese. Projektim, Supervizion, Kolaudim ne fushen e ndertimeve civile,ushtarake objekte te tjera si rrugeura,kanalizime etj. Tregtim, transport dhe perdorim (per te kryer punime te ndryshme ) te lendeve plasese. Zyre konsulence juridike.Blerje, grumbullim, transport, perpunim, shitje e skrapit dhe hekurit dhe metale te ndryshme. Transport mallrash me mjete jashte norme.Sherbime te ruajtjes se personave, objekteve e veprimtarive (1.3 A).Sherbim te ruajtjes, transportimit e shoqerimit te vlerave monetare e sendeve te cmuara (1.3 B). Prerjen e policave siguruese Blerje - Shitje automjetesh. Kontroll të mjeteve të transportit në regjim të temperaturave të kontrolluara sipas marrëveshjes ATP. Kultivim dhe rritje e peshkut ne rezervate, tregtim me shumice dhe pakice i tij. Kryerjen e 2 Inspektimit, kalibrimin, instalimit, aktivizimit, riparimit, montimit, zmontimit dhe cdo operacion tjeter per tahografet analog dhe dixhital. Inspektim dhe kontrollin e karakteristikave izotermike te mjeteve, vleresimin e perputhshmerise ne ambjentin e autorizuar te kryerjes se provave me ekspert te emeruar dhe cdo operacion tjeter per ATP. Inspektimin e mjeteve per leshimin e certifikates se miratimit ADR dhe cdo operacion tjeter per ADR. Inspektim fillestar , periodik, i ndermjetem dhe jashte rradhe per cisternen rrugore ADR brenda dhe jashte saj ne funksion te kontrollit te miratimit te tipit. Leshim te certifikates per cisternen rrugore te mallrave te rrezikshme ADR. Kryerjen e Inspektimit, kalibrimin, instalimit, aktivizimit per tahografet analog dhe dixhital. Trupë inspektuese pale e trete per inspektim tahograf, inspektim ADR, inspektim ATP , ene nen presion, si dhe Laborator testimesh pale e trete. Kontroll teknik vjetor dhe periodik te mjeteve rrugore. Transport mallrash dhe pasagjeresh Brenda dhe

jashte vendit per vete dhe per te trete. Verifikim periodik i percaktimit volumor te cisternave rrugore (autobote) dhe hekurudhor me kontator volumor. Inspektim teknik te mjeteve rrugore. Tregtim me shumice dhe pakice artikuj te ndryshem, industrial (perjashtohen pajisjet qe kane te bejne me ATP,ADR, Tahograf, matje volumetrike, inspektim teknik mjeti rrugor). Ndertime civile, industriale dhe ushtarake, rrugeve dhe kanalizimeve. Rikonstruksion i ndertimeve civile, rrugeve, kanalizimeve dhe ndertesave ushtarake. Mirembajtje te rrugeve. Grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte dhe mbetjeve te parrezikshme. Dezinfektim, Dezinsektim, deratizim te te gjitha ambienteve tregtare, arsimore, familjare etj. Eleminim insektesh, minjsh etj. Import-eksport, tregtim me shumicë e me pakicë, instalimi dhe shërbimi i produkteve të sistemeve të sigurisë, kamerave të sigurisë. Tregtim, transportimin e mallrave dhe instalimin e mjeteve të sistemit vrojtues, sinjalizuës, audioviziv, rrobave dhe veshmbathjeve të punonjësve të sigurise, mjeteve të mbrojtjes kundra zjarrit, pajisjeve të ndërlidhjes, të teknikave të tjera të lejuara nga legjislacioni, si dhe projektimin, instalimin dhe programimin e pajisjeve të telekomunikacionit, radio komunikacionit dhe sistemeve të kontrollit dhe monitorimit në distancë të automjeteve me GPS. Ofrime rrjetesh dhe shërbimesh të komunikimeve elektronike. Ndërtim i linjave me fibra optike. Punime elektrike, ndërtime për nënstacionet, kabinat etj. Blerje, shitje, perdorim, instalim dhe mirembajtje te paneleve diellore ne fushen e prodhimit te energjise elektrike

**Drejtimi i shoqerise.**

Shoqeria ka nje perfaqesues ligjor z. Lush Osmani. Nderkohe shoqeria per aktivitete te vecanta ka caktuar administrator:

1. Gention Baja, administrator per aktivitetin e tregtise se pajisjeve elektronike dhe elektroshtëpiake te shoqërise;

2. Bardhok Osmani, administrator per aktivitetin e tregtise se karburanteve dhe nenprodukteve te tij (nafte, benzine, solar, bitum, gaz), tregtim, vajra lubrifikante në menyre stacionare, distributor dhe ambulant, te lavazhit së shoqërisë;

3. Lin Osmani, administrator per aktivitetin e transportit të mallrave dhe pasagjereve brenda dhe jashtë vendit, per vete dhe per te trete transport mallrash me mjete jashtë norme;

4. Seferin Osmani, Kontroll teknik vjetor dhe periodik te mjeteve rrugore, Verifikim periodik i percaktimit volumor te cisternave rrugore (autobote) dhe hekurudhor me kontator volumor. Inspektim teknik te mjeteve rrugore. Tregtim me shumice dhe pakice artikuj te ndryshem, industrial (perjashtohen pajisjet qe kane te bejne me ATP,ADR, Tahograf, matje volumetrike, inspektim teknik mjeti rrugor) se shoqerise. Inspektimin e mjeteve per leshimin e certifikates se miratimit ADR dhe (cdo operacion tjeter per ADR.Inspektim fillestar, periodik, i ndermjetem dhe jashte rradhe per cisternen rrugore ADR brenda dhe jashte saj ne funksion te kontrollit te miratimit te tipit. Leshim te

certifikates per cisternen rrugore te ma.l lrave te rrezikshme ADR. Kryerjen e Inspektimit, kalibrimin, instalimit, aktivizimit per tahografet analog dhe dixhital. Trupe inspektuese pale e trete per inspektim tahograf, inspektim ADR, inspektim ATP, ene nen presion, si dhe laborator testimesh pale e trete. administrator te shoqerise per aktivitetin e servisit, blerje -shitje automjetesh, kontroll te mjeteve te transportit ne regjim te temperaturave te kontrolluara sipas marreveshjes ATP, kryeijen e inspektimit, kalibrimin, instalimit, aktivizimit, riparimit, montimit, zmontimit dhe cdo operacion tjeter per tahografet analog dhe dixhital. Inspektim dhe kontrollin e karakteristikave izotermike te mjeteve, vleresimin e perputhshmerise ne 4 ambjentin e autorizuar te kryerjes se provave me ekspert te emeruar dhe cdo operacion tjeter per ATP

5. Albana Baja, administrator per aktivitetin e sherbimeve te ruajtjes se personave, objekteve te veprimtarive, sherbim te ruajtjes, transportimit e shoqerimit te vlerave monetare e sendeve te cmuara.Me certifikaten nr.292/6 Prot,e dates 23.04.2021 si titullare Subjekti

6. Dritan Osmani administrator per aktivitetin e ndërtimeve civile e publike, transport dhe perdorim e lëndëve plasëse (per të kryer punime të ndryshme), projektim, supervizionim, kolaudim në fushën e ndërtimeve civile, ushtarake objekte te tjera si rrugë, ura, kanalizime, blerje, grumbullim, transport, përpunim, shitje e skrapit dhe hekurit dhe metale te ndryshme, tregtisë se materialeve te ndërtimit, inerteve të ndryshme, shfrytëzim mineralesh, mirêmbajtje të rrugêve, grumbullim dhe transport I mbetjeve inerte dhe mbetjeve të parrezikshme

7. Përparim Baja, administrator per aktivitetin e bar - kafese, restorantit se shoqërise.

## IV. SITUATA EKONOMIKO - FINANCIARE E SHOQERISE para momentit te zmadhimit te kapitalit aksionar dhe te rezerves ligjore.

Gjendja e **Kapitaleve**, te shoqerise "SHPRESA-AL"shpk, te pasqyruara ne pasqyrat financiare te vitit 2022 eshte 211.188.672 leke.

Nga verifikimet e kryera nga ana ime ne dokumentacionin kontabël, rezulton se kapitalet e shoqërisë janë te pasqyruara ne pasqyra financiare sipas dispozitave ligjore sipas përcaktimit ne nenin 117 te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Pasqyrat financiare 2022 te audituara paraqiten si me poshte:

Pasqyra e Performances *(sipas natyres)*

| | Periudha Raportuese | Periudha Para ardhese |
|---|---|---|
| Aktivitetet e vazhdueshme | | |
| Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit | | |
| Te ardhurat nga aktiviteti kryesor | 1,802,139,250 | 2,330,345,099 |
| Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 1 | | |
| Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 2 | | |
| Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 3 | | |
| Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit | | |
| Te ardhura nga investimet | | |
| Te ardhura te tjera | | |
| Ndryshimi ne inventarin e mallrave dhe prodhimit ne proces | | |
| Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme | (1,356,040,800) | (1,822,665,196) |
| Shpenzime amortizimi dhe zhvleresimi | (46,626,851) | (40,934,346) |
| Shpenzime personeli | (208,016,424) | (178,464,783) |
| Te ardhura/(shpenzime) financiare, neto | (13,836,819) | (28,410,955) |
| Shpenzime te tjera | (134,134,322) | (232,310,918) |
| Pjesa e fitimit/(humbjes) nga pjesmarrjet (filjal/dege) | | |
| Pjesa e fitimit/(humbjes) nga bashkimet ekonomike (joint-venture) | | |
| Fitime te njohura nga shitja e pjesmarrjeve | | |
| Te tjera *(pershkruaj)* | | |
| **Fitimi/(humbja) para tatimit** | **43,484,034** | **27,558,901** |
| **Tatimi mbi fitimin** | **(6,895,414)** | **(4,685,473)** |
| **Fitimi/(Humbja) e periudhes nga aktiviteti i vazhdueshem** | **36,588,620** | **22,873,428** |
| Aktivitetet e nderprera | | |
| Fitimi/(Humbja) e periudhes nga aktivitetet e nderprera | | |
| Fitimi/(Humbja) e periudhes (A) | 36,588,620 | 22,873,428 |
| Fitimi/(Humbja) per: | | |
| Zoteruesit e njesise ekonomike meme | | |
| Interesat e pakices | | |
| Fitimet per aksion | | |
| Nga aktivitetet e vazhdueshme dhe te nderprera | | |
| Fitimet Baze per Aksion | | |
| Fitimet e Pakesuara per Aksion | | |
| Nga aktivitetet e vazhdueshme | | |
| Fitimet Baze per Aksion | | |
| Fitimet e Pakesuara per Aksion | | |
| **Fitimi/(Humbja) e periudhes (A)** | **36,588,620** | **22,873,428** |
| Te ardhura te tjera gjitheperfshirese | | |
| Vlera qe nuk do te riklasifikohen me pas ne fitime/humbje | | |
| Fitime nga rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale | | |
| Pjesa e te ardhurave gjitheperfshirese nga pjesmarrjet | | |
| Te tjera *(pershkruaj)* | | |
| Tatim fitimi i vlerave qe nuk do te riklasifikohen me pas ne fitime/humbje | | |
| Shuma | - | - |
| Vlera qe mund te riklasifikohen me pas ne fitime/humbje | | |
| Diferenca (+/-) nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja | | |
| Diferenca (+/-) nga rivleresimi i aktiveve financiare te mbajtura per shitje | | |
| Fitime/(Humbje) nga mbrojtja nga fluksi i mjeteve monetare (Cash Flow Hedges) | | |
| Te tjera *(pershkruaj)* | | |
| Tatim fitimi i vlerave qe mund te riklasifikohen me pas ne fitime/humbje | | |
| Shuma | - | - |
| Totali i te ardhurave te tjera gjitheperfshirese per periudhen pas tatimit (B) | - | - |
| **Totali i te ardhurave gjitheperfshirese per periudhen (A+B)** | **36,588,620** | **22,873,428** |

Pasqyra e Pozicionit Financiar

| Me ndarje ne afatshkurter dhe afatgjate | Periudha Raportuese | Periudha Para ardhese |
|---|---|---|
| **AKTIVET** | | |
| Aktive afatgjate | | |
| Aktive afatgjata materiale | 300,334,300 | 304,391,698 |
| Aktive afatgjata materiale per investim | | |
| Emri i mire | | |
| Aktive te tjera afatgjata jo-materiale | | |
| Investime ne pjesmarrje | | |
| Investime ne bashkime ekonomike (joint-ventures) | | |
| Aktivet tatimore te shtyra | | |
| Kerkesa per qira financiare afatgjata | | |
| Huadhenie afatgjata | 177,209,826 | 189,143,423 |
| Aktivet biologjike | | |
| Aktive te tjere financiare afatgjate | | |
| Aktive te tjera (pershkruaj) | | |
| **Totali i aktiveve afatgjata** | **477,544,126** | **493,535,121** |
| Aktive afatshkurtra | | |
| Inventare dhe aktive biologjike afatshkurter | 311,777,009 | 288,996,110 |
| Llogari te arketueshme tregtare dhe llogari te tjera te arketueshme | 912,436,114 | 792,910,509 |
| Kerkesa ne lidhje me kontratat e ndertimit | | |
| Aktive te tjere financiare afatshkurter | | |
| Tatim fitimi i parapaguar | | |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | 21,515,244 | 41,787,854 |
| Aktive te tjera (pershkruaj) | 65,039,880 | 80,842,774 |
| | 1,310,768,247 | 1,204,537,247 |
| Aktive te klasifikuara si te mbajtura per shitje dhe te perfshira ne grupet e nxjerjes jashte perdorimit te klasifikuara | | |
| **Totali i aktiveve afatshkurtra** | **1,310,768,247** | **1,204,537,247** |
| **TOTALI I AKTIVEVE** | **1,788,312,373** | **1,698,072,368** |
| **DETYRIMET DHE KAPITALI** | | |
| Kapitali dhe Rezervat | | |
| Kapitali i nenshkruar dhe primi i kapitalit | 134,530,343 | 134,530,343 |
| Rezerva te tjera (Ligjor dhe te tjera) | 40,069,709 | 40,069,709 |
| Fitime/(humbje) te mbartura | 36,588,620 | 22,873,428 |
| | 211,188,672 | 197,473,480 |
| Shuma te njohura direkt ne kapital ne lidhje me aktivet e mbajtur per shitje | | |
| Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike | 211,188,672 | 197,473,480 |
| Interesa jo-kontrollues | | |
| **Totali i kapitalit** | **211,188,672** | **197,473,480** |
| Detyrime afatgjata | 443,448,639 | 432,950,474 |
| Huamarrje | 75,239,920 | 41,776,791 |
| Detyrime financiare te tjera | | |
| Detyrime per perfitime pensionesh | | |
| Detyrime tatimore te shtyra | | |
| Provizione | | |
| Te ardhura te shtyra | | |
| Detyrime te tjera (pershkruaj) | | |
| Totali i detyrimeve afatgjata | 518,688,559 | 474,727,265 |
| Detyrime afatshkurtra | | |
| Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari te tjera te pagueshme | 656,045,714 | 676,567,208 |
| Detyrime ndaj klienteve per kontratat e ndertimit | | |
| Huamarrje | 341,942,046 | 316,810,155 |
| Detyrime financiare te tjera | | |
| Detyrime per tatimin aktual | | |
| Provizione | | |
| Te ardhura te shtyra | - | 3,021 |
| Detyrime te tjera (tatimore, ndaj punonjesve dhe sigurimet,dividente pe | 60,447,382 | 32,491,239 |
| | 1,058,435,142 | 1,025,871,623 |
| Detyrimet e perfshira ne grupet e nxjerjes jashte perdorimit te klasifikuara si te mbajtura per shitje ne perputhje m | | |
| Totali i detyrimeve afatshkurta | 1,058,435,142 | 1,025,871,623 |
| **Detyrime totale** | **1,577,123,701** | **1,500,598,888** |
| **TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT** | **1,788,312,373** | **1,698,072,368** |

Me Vendim te ortakut nr.48, date 29.06.2023 eshte vendosur zmadhimi i kapitalit dhe i rezerves ligjore, si me poshte:
*Fitimi i vitit ushtrimor 2022 që rezulton në shumën 36.588.620 lekë do të shpërndahet si më poshtë:*
*a. Për shpërndarje dividenti ne shumën 15.118.963 lekë,*
*b. Për zmadhim të kapitalit aksionar në shumën 21.469.657 lekë*

Me Vendim Nr.50, date 12.12.2023 jam caktuar si eksperte në hartimin e raportit për vleresimin e zmadhimit te kapitalit me fitimet e vitit 2022.

## IV-2. KAPITALI AKSIONAR PAS RRITJES.

Zmadhimi i kapitalit është parashikuar te realizohet nëpërmjet kalimit ne kapital te fitimeve te vitit 2022.
Ne përshtatje dhe përputhje me Ligjin Nr. 129/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtaret dhe shoqerite tregtare", neni 8 "*Kapitali i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ndahet ne nje numer kuotash, ne raport me kontributin dhene nga cdo ortak ne shoqeri. Cdo ortak zoteron nje kuote te vetme ne shoqeri*; behen ndryshimet perkatese.

Duke qene se Zmadhimi i kapitalit realizohet nepermjet kapitalizimit te fitimit te vitit 2022, kuota dhe ne pershtatje te ligjit sipercituar kuotat behet 1(nje), por vlera nominale e saj ndryshon dhe zoterimi i ortakut te vetem mbetet i pandryshuar.

Gjendja e kapitalit perpara zmadhimit paraqitet ne vlere 211.188.672 leke:

| | |
|---|---|
| Kapitali i regjistruar.......................... | 134.530.343 leke |
| Rezerva Ligjore.................................. | 13.453.034 leke |
| Rezerva te tjera.................................. | 26.616.675 leke |
| Fitimi i vitit........................................ | 36.588.620 leke |

Gjendja e **Kapitalit Aksionar**, pas zmadhimit, paraqiten ne total ne shumën **156.000.000 leke**, e perbere nga **1 kuote**, me vlere 156.000.000 leke, e zotëruara nga ortaku i vetem Z. Lush Osmanaj, nga te cilat kapital ne para 128.519.657 leke dhe kapital ne natyre 27.480.343 leke.

PASQYRAT E KAPITALIT PAS NDRYSHIMIT TE KAPITALIT AKSIONAR

| **Kapitali** | | **Pas zmadhimit** | **31.12.2022** |
|---|---|---|---|
| Kapitali i nenshkruar dhe primi i kapitalit | | 156,000,000 | 134,530,343 |
| Rezerva te tjera (Ligjor dhe te tjera) | | 40,069,709 | 40,069,709 |
| Fitime/(humbje) te mbartura | | | 36,588,620 |
| Shuma te njohura direkt ne kapital ne lidhje me aktivet e mbajtur per shitje | | | |
| **Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike** | | **196,069,709** | **211,188,672** |
| Interesa jo-kontrollues | | | |
| **Totali I Kapitali** | | **196,069,709** | **211,188,672** |

Ne këto kushte Aktivi i Bilancit te shoqërisë ngelet i pa ndryshueshëm, ndërsa ne Pasqyren e kapitaleve te shoqerise për vitin 2023 do te pasqyrohen ndryshimet përkatëse si me sipër, brenda grupit te **Kapitalit**.

## V. KONKLUZIONE PERFUNDIMTARE

Ne përmbushje te misionit tim si Audituese Ligjore, caktuar nga ortaku i vetem i shoqërisë **"SHPRESA-AL" shpk**, për përgatitjen e Raportit për verifikimin e procedurave të zmadhimit te Kapitalit të shoqërisë jap opinion tim si vijon:

1. Vendimi i ortakut te vetëm te shoqërisë është i drejte dhe i bazuar ne ligj.
2. Zmadhimi i kapitalit realizohet nëpërmjet kalimit ne kapital fitimet e vitit 2022.
3. Kapitalit i shoqërisë **"SHPRESA-AL" shpk**, nga 134.530.343 leke, pas zmadhimit shkon ne **156.000.000 leke**, i ndare ne 1 kuote, me vlere 156.000.000 leke, e zotëruar nga ortaku i vetem Z. Lush OSMANAJ.
4. Kapitalit i shoqërisë **"SHPRESA-AL" shpk**, perbehet nga kapital ne para dhe ne natyre:

Kapitali ne para eshte ne vlere 128.519.657 leke;
Kapitali ne natyre eshte ne vlere 27.480.343 leke.

*Perfundimisht, mbi bazën e analizave te mësipërme, opinioni im per vendimin e ortakut te vetem per zmadhimit e Kapitalit se shoqerise **"SHPRESA-AL" shpk** është sipas Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"dhe Ligjit Nr.7923 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".*

Raporti i paraqitur prej meje mund te miratohet nga ana e shoqerise dhe te kalohet per kryerjen e veprimeve te metejshme ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Shpresa BREÇANI
Audituese Ligjore
Nr.Lic.143

SHPRESA BREÇANI
Auditüese Ligjore
Nr.Liç. 143

Tirane, me 18.12.2023